

FATOS KONGOLI
JETË NË NJË KUTI SHKREPËSESH
ROMAN

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

JETË NË NJË KUTI
SHKREPËSESH

ROMAN

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2007

Botues: Fatmir Toçi
Korrektore letrare: Dorina Talo
Përkujdesja grafike: Mereme Nelaj
Kopertina: Irena Toçi

ISBN 978 - 99943 - 1 - 235 - 1

© Autori dhe Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollesha", K.Postare 1420, Tiranë

Tel.: (4) 240116; 258893

Tel./Fax: (4) 240117

E-mail: toena@toena.com.al; info@toena.com.al; toena@icc.al.eu.org

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

1.

Kur ra zilja e derës së jashtme, ai po rrinte pranë tryezës. Me një shishe *Jack Daniel's*, të çuar përtej gjysmës. Dhe një gotë të boshatisur. Tringëllima, si e frikur, u pasua nga një heshtje e nderë dhe ai mendoi se i kishin bërë veshët. Mirëpo zilja u përsërit, në të njëjtën mënyrë, si e frikur. Mendja i shkoi te Dina, njëra nga kamerieret e lokalit në katin përdhes të pallatit, një kafe-bar në hyrje të të cilit shkruhej “Pulëbardha”.

Prej gjashtë muajsh, qysh se ishte vendosur këtu, ai zbriste te “Pulëbardha” rregullisht, për kafënë e mëngjesit, qëllonte edhe mbrëmjeve. Ndonjëherë rrinte gjatë, gjithmonë në pjesën ku shërbente Dina, në një tryezë afër faqes së

xhamtë. Në fillim ulej atje pa ndonjë qëllim, thjesht sepse mund të shihte lëvizjet në rrugë. Në fillim ai as që e dinte se tryeza ku ulej i përkiste zonës së Dinës, madje kësaj të fundit nuk i dinte as emrin. Pastaj mbërriti një çast dhe, pashmangshmërisht, ia mësoi emrin. Me këtë rast nuk u habit kur vuri re se tjetra dinte për të shumë gjëra. Fjala vjen, emrin e bashkëshortes së tij, i njohur po aq sa dhe portreti i saj: punonte në kanalin televiziv “Sirius” dhe intervistonte politikanë e personalitete të larta. “Me ç’thuhet, guxoi të shkonte më tej Dina, qenkeni ndarë dhe tani jetoni vetëm.”

Ai nuk u habit që kamerierja, njëzetedy-vjeçare, dinte kaq shumë hollësira për të: ishte pronar i sallës së lokalit. Nga kjo pronësi vilte një qira mujore prej dy mijë eurosh, hollësi që Dina, e dinte apo jo, nuk ia zuri me gojë. Nisur nga zelli i veçantë i saj për t’i shërbyer dhe fakti se i prishej frymëmarrja kur fliste me të, atij iu duk e natyrshme ta ftonte të pinin një kafe bashkë. Jo në lokal. E ftoi ta pinin në apartamentin e tij, pesë kate më sipër, ftesë që zonjusha kureshtare e pranoi. Një pasdite ajo e njoftoi për mbërritjen e saj me anë të citofonit. Sapo i dëgjoi zërin, ai u ngut t’i hapte derën e hyrjes, poshtë, t’i linte hapur edhe derën e apartamentit, ku ajo u shfaq me një T-shërt të gjelbër, një fund të shkurtër xhins, dhe hutimin e zakonshëm.

Para se të shkonin në shtratin dopio të dhomës së gjumit, ku ende nuk ishte shtrirë ndonjë femër, tek pinin uiski, - zonjushës i pëlqente uiski, - ai e gjykoi të nevojshme t'i saktësonte se intervistuesja e politikanëve dhe personaliteteve të larta nuk kishte qenë mirëfilli bashkëshortja e tij. Ata vetëm sa kishin ndarë të njëjtin shtrat për nja dy vjet, derisa asaj i ishte mbushur mendja t'i jepte fund bashkëjetesës së tyre.

Dina nuk e kuptoi përse tjetri e pa të nevojshme t'ia bënte këtë saktësim. Në sallonin e madh, tek pinin uiski, sytë i zunë gjithandej, mbi mure, deri mbi aparatin e televizorit, fotografinë në poza të ndryshme të gruas, që ai këmbëngulte se nuk kishte qenë mirëfilli bashkëshortja e tij. Vetvetiu i erdhi në majë të gjuhës një pyetje. Kur punët ishin kështu për ç'arsye vazhdonte ta mbante gjithandej portretin e saj? Intuita femërore e frenoi. "Përderisa e mban, tha me vete, do të thotë se dëshiron ta mbajë. Përderisa ndodhem këtu vetëm për të kaluar një pasdite, nuk më takon të fus hundët atje ku s'duhet."

Ajo kaloi atje shumë pasdite. Me raste, ndonjë natë. Portreti i kudondodhur i gruas, - ai gjendej edhe mbi një komodinë në dhomën e gjumit, pra në shtratin ku bënë dashuri, - nuk e shqetësonte. Megjithatë, një ditë, si bënë dashuri, sytë i mbetën te portreti. Ishte një bionde nja tridhjetë vjeç, me syze optike, me

një vështrim të mjegullt. Ajo mendoi se biondes së fotografisë syzet i shkonin jashtëzakonisht. Ndoshta prandaj i mban, arsyei më tej, sepse i shkojnë. Edhe ajo vetë, po t'i shkonin, ka të ngjarë të mbante një palë syze, sa për formë, pa numër. Nuk ishte torollake si një mikeshë e saj, e cila, ngaqë dikush i paskej thënë se syzet do t'i shkonin shumë, bleu një palë, optike, nga ato që shiten trotuarëve, i mbajti ca kohë për t'u dukur interesante dhe jo vetëm u bë objekt talljesh, por rrezikoi të qorrohej.

“Duhet ta kesh dashur shumë”, i tha mashkullit tek rrinte shtrirë me kokën mbi jastëk, duke vështruar bionden e fotografisë. Pasoj një heshtje dhe ajo u pendua që i kishte nxjerrë këto fjalë. Ai e ktheu nga vetja. “Ti pallohesh njëqind herë më bukur, vërejtji. Ajo s'dinte të pallohej. Bënte sikur ndizej, por kot. Ishte akull, si të bëje dashuri me një statujë.”

Ai u ngrit dhe zuri të vishej. Ajo mbeti në krevat, me një djersitje të lehtë, e pështjelluar. Më shumë për të mbledhur veten nga ky vulgaritet i papritur i partnerit, vajti në banjë, qëndroi nën dush një copë herë të gjatë. Kur doli, e veshur dhe më e qetë, tjetrin e gjeti në sallon, me shishen e uiskit përpara. “Ke menduar se unë jam i çmendur”, i foli befas ai. Ajo ngriu. Në sytë e tij vuri re një xixëllim të çuditshëm. “Nuk është e vërtetë”, u ngut t'i përgjigjej. “Mos gënje, këmbënguli tjetri,

ke menduar se unë jam i çmendur.” “Ajo, - ai tregoi me dorë portretin e biondes, - më thoshte shpesh se unë jam i çmendur...” Kamerierja, e hutuar dhe e bezdisur, u përpoq t’i jepte bisedës ngjyrë shakaje. “Unë s’kam arsye të mendoj kështu vetëm sepse, sipas gjykimit tënd, ish-bashkëshortja jote... më fal... femra me të cilën ke bashkëjetuar nja dy vjet, nuk dinte të pallohej, ndërsa unë di. Më pëlqen komplimenti. Nuk ta them për kompensim, por edhe ti pallon bukur.”

Pak më vonë, jashtë apartamentit, duke pritur ashensorin për të zbritur poshtë, e mblodhi të mos kthehej më atje. Ai mashkull ndrydhte brenda vetes diçka të ethshme, që i shtiu frikën. Jo, s’do të shkonte më tek ai, pavarësisht se, siç ia kishte pohuar çiltërsisht, ai pallonte bukur, me një energji të papërballueshme. Ndoshta për këtë arsye ajo e shkeli vendimin e saj që të nesërmen. Tek pinte kafënë e mëngjesit, që ia shërbeu në tryezën e tij, ai i tha se po të dëshironte, e priste pasdite. Dhe ajo pranoi.

Tringëllima e ziles u përsërit për të tretën herë, gjithmonë e shkurtër, si e frikur. Ai vështroi orën: dymbëdhjetë e njëzet minuta. Mundësinë se ndoshta ishte Dina e përjashtoi. Dina e vizitonte rrallë në këtë orë. Dhe nuk ngjitej tek ai kur shërbente në lokal. Nëse ngjitej, e lajmëronte nëpërmjet citofonit.

Ai mori shishen, mbushi gotën. Ktheu gjysmën e saj. Me gotën në dorë, vajti drejt derës. E hapi dhe mbeti i zhgënjyer: iu shfaq një rome. Ai nuk priste njeri, aq më pak një rome. Gati i nervozuar, i erdhi ta shmangte atë vizitore të pazakontë në pallatin e tyre duke i mbyllur derën. Çastin e fundit ndërroi mendje. I hodhi një vështrim nga këmbët te koka dhe tha me vete: “Për besë, pse jo?” “Eja, i foli, futu brenda!”

Tjetra nuk e kuptoi menjëherë ftesën. Ishte e re, tetëmbëdhjetë-nëntëmbëdhjetë vjeç. Mbante veshur një bluzë të hapur në gjoks, ku i varej një kryq i vogël. Atë ditë korriku bënte vapë, ishte e natyrshme ta mbante bluzën të shkopsitur, pa e çarë kokën se gjinjtë e saj tërhiqnin sytë e meshkujve. Ajo nuk shqetësohej nga sytë e meshkujve. Mirëpo nuk i kishte ndodhur të gjendej kështu, vetëm për vetëm, para një mashkulli të bardhë, vështrimin e të cilit nga këmbët te koka e kishte ndier në thellësi të qenies. Për më tepër ai po e ftonte të futej brenda. Duke e zbërthyer ftesën në mënyrën e vet, ia ktheu: “Jo ore, dashke ti!”

Ai nuk ia përsëriti ftesën dy herë. Kur vajza formuloi përgjigjen, i mbylli derën, ia përplasi. Pastaj vajti zuri vend në kolltuk, pranë tryezës. Gjynah, psherëtiu duke ia ngulur sytë portretit të biondes me syze në fotografinë e vendosur përballë, mbi aparatën e televizorit. Do të bëja seks këtu, në kanape, të më shihje nga të gjitha

pozicionet e tua. Me një rome... Si të duket me një rome? Nuk ishte dhe aq e keqe.

Fillin e mendimit ia ndërpreu tringëllima për të katërtën herë e ziles. Ai vështroi sërish portretin. Iu prish mendja më duket, foli. Dhe vajti të hapte derën. Vajza u fut brenda, hodhi disa hapa e druajtur. Ai e kuptoi, ajo gjendej për herë të parë në një mjedis jo aq të zakonshëm për të. Iu afrua, i tha të ulej në njërin nga kolltukët. Ajo nuk pranoi. Ajo deshi të mësonte përse e kishte ftuar brenda dhe ç'kërkonte prej saj. Ai i ra drejt. Të pallohemi, i tha. Po të duash, shtoi kur vuri re se ajo shtrembëroi turinjtë, po të kesh dëshirë. Unë pallohem kur ma jep truri, ia ktheu tjetra, s'jam nga ato që pallohen me para. S'po të kërkoj të pallohemi me para, saktësoi ai. Mund të pallohemi për qejf. Po s'pate qejf më kërko ndonjë gjë, çfarë të pëlqen, dhe pirdhu!

Vajza zuri të vërtitej nëpër sallon duke vështruar portretet e kudondodhura të biondes me syze, pa bërë ndonjë koment, as ndonjë pyetje. Pyetjen ia drejtoi ai. "Si erdhe deri këtu lart, i tha, kush ta hapi derën?" "Askush, iu përgjigj ajo, e gjeta të hapur. Trokita me radhë në të gjitha dyert kat më kat, por s'kishte njeri. Përveç teje. Dhe ti dashke të pallohemi. E di se jam e fejuar dhe po ta marrë vesh i fejuari im vjen e na vret të dyve?"

Ai ktheu një gllënjikë uiski. Trupi i vajzës çlironte një erë të rëndë, erën e qenieve

të palara. E përfshiu neveria, megjithatë këmbënguli. “I fejuari yt as na sheh, as do të marrë vesh gjë. Tani ose rri, ose pirdhu sa s’të kam flakur jashtë...” “Na, more ti, ia priti ajo, na trembe! Provo të më prekësh me dorë po nuk ia dhashë ulërimës.” E, si tha kështu, zuri vend në njërin nga kolltukët.

Për një çast ai u bë esëll. “Kjo është marrëzi, mendoi. Ta përze sa nuk është vonë!” Ndërkaq, tjetra, e rehatuar në kolltuk, po e shihte në mënyrë provokative. “Hë, pra, i tha, pse s’më pallon? Apo ke frikë se ia jap ulërimës?!” “Jo, ia ktheu ai, nuk kam frikë se ia jep ulërimës. Këtu ulëri sa të duash, s’të dëgjon njeri. Nuk të palloj sepse je e qelbur, mban erë të keqe. Sa kohë ke pa u larë?”

“Më marrsh pleshtat”, tha vajza dhe u ngrit në këmbë. Ai kujtoi se, siç erdhën punët, ajo do të kërkonte të ikte. Nuk ndodhi kështu. Vajza zuri të vërtitej edhe një herë nëpër sallon duke qëndruar njëfarë kohe përpara çdo fotografie të biondes me syze. Përsëri nuk bëri ndonjë koment, as i drejtoi ndonjë pyetje. Në fund të inspektimit shfaqti një kërkesë të papritur. “Më trego ku është banja, i tha, dua të lahem. Banja jote duhet të jetë si ato që kam parë nëpër filma, me dush dhe me vaskë.” Ai iu përgjigj se banja e tij ishte ashtu si nëpër filma, me dush dhe me vaskë. Po të donte, mund të futej që tani, të lahej. Vajza u ngut t’ia kthente me atë shprehjen e saj “Jo, more, dashke ti”. Pastaj

ideja e mashkullit të bardhë i pëlqeu. Së paku atij kështu iu duk.

E zuri për dore, e tërhoqi drejt banjës. Ajo e ndoqi pa ndonjë shenjë kundërshtimi. Banja ishte e bollshme, të gjitha pajisjet prodhim italian, të bardha, ndërsa dyshemeja dhe muret të veshura me pllaka ngjyrë blu. Nën efektin e uiskit, ai nuk po e ndiente më erën e rëndë të saj. Dhe i hipi një dëshirë e verbër të bënin seks aty, në vaskë, pavarësisht në do ta shihte apo jo portreti i kudondodhur. Si ndër ethe, rregulloi ujin. Vaska zuri të mbushej dhe ai zbrazti në të shampo. Vajza qëndronte në këmbë, duke ndjekur gufmimin e shkumës. Ndërsa vaska mbushej dhe shkuma gufmohej, atij i mbërriti sërish era e rëndë e tjetrës. “Jam i çmendur, tha me vete, unë jam i çmendur, duhet ta përzë këtë qenie të pistë.” Në vend të kësaj, kur vaska u mbush plot, i kërkoi të zhvishej. Ajo i tha se do të zhvishej vetëm nëse ai dilte nga banja. Këto i shqiptoi me të folurën karakteristike prej romeje, ku kishte diçka vazhdimisht provokuese. Ai qeshi, tjetra po luante koketën.

Doli nga banja, vajti pranë tryezës, i dha fund uiskit të mbetur në gotë. Prej andej vajti në dhomën e gjumit. U zhvesh, mori në komo një pelerinë-peshqir, u mbështoll me të dhe u kthye përsëri në sallon. Portretet e kudondodhura të biondes me syze e vështruan në heshtje. Një heshtje përbuzëse, siç iu duk.

U shkëput prej tyre dhe pa e zgjatur më iu drejtua banjës.

Shfaqjen e tij vajza e priti me një klithmë. Në gjendje më normale, ai do të kishte mundur të kuptonte se klithma e lëshuar prej saj nuk përmbante kurrfarë koketërie. Mirëpo shqisat e tij e zbërthyen mesazhin gabim. Ai hoqi pelerinën, e vari te një mbajtëse mbi mur dhe, duke ekspozuar para vajzës vitrinën e tij, u fut në vaskë, në anën e kundërt të saj. Me të ndier prekjen e këmbëve të mashkullit nën ujë, vajza u tërhoq në qoshen tjetër. “Mos guxo të më afroresh, iu hakërrye, mos guxo të them!” Dhe u përpoq të mbulonte gjinjtë me duar. Ajo kishte ca gjinj rrumbullakë. Një fytyrë gati të bukur. Shqisat e tij e pasqyruan shumë të bukur. Dhe shumë sensuale. Ai u err nga dëshira, megjithëse një lloj egërsie në sytë e zinj të vajzës nuk ishte aspak koketëri. Errësimi i tij u bë i plotë kur vajza provoi të ngrihej në këmbë dhe ai kërceu përtpjetë me instinktin e një grabitqari që i sulet presë përpara se kjo t’ua mbathë. Për një çast arriti ta zotëronte, e tërhoqi nga vetja. Ndjeu fërgëllimën e një trupi të nxehtë, hapjen e këmbëve të saj, butësinë e gjinjve dhe, kur mendoi se ajo, duke iu ngjeshur, e lëshoi veten në duart e tij, ulëriu nga një dhimbje e tmerrshme: ajo ia kishte ngulur dhëmbët në gjoks.

Vetvetiu i dha një të shtyrë. Ai nuk e llogariti forcën e së shtyrës. Deshi vetëm të çlirohej nga dhimbja e kafshimit mbi sisën e majtë, ku tani

hapej një plagë. “Debile, rënkoi, debile!” Dhe, i errur nga dhimbja, iu desh një copë herë të kuptonte ç’kishte ndodhur: trupi i vajzës gjendej i flakur matanë vaskës.

E përshkoi një e rrëqethur. Tjetra dergjej në një pozicion të frikshëm, në shpinë. Njëri krah i zgjatej poshtë, si të donte të mbulonte seksin, tjetri përthyhej mbi gjinjtë. Koka i qe shembur pas bidesë, me sytë hapur. Ai doli nga vaska, i vajti pranë. Pa guxuar ta prekte, i kërkoi të mos tallej. “Lëviz, i tha, mos u shtir!” Vajza nuk iu përgjigj. Vazhdonte të qëndronte në pozicionin e saj të frikshëm, me vështrimin ngulur diku. Atëherë ai u përkul mbi të, ia ngriti kokën me të dyja duart dhe u llahtaris. Duart iu përgjakën. E përgjakur ishte edhe ana e bidesë. Një bllanë gjaku hapej gjithashtu mbi dysheme. “O Zot, belbëzoi, o Zot!” Dhe iu përzie. E la vajzën, mbërriti grykën e WC-së, shkulmet e të vjellave i shpërthyen me tërbim, derisa nuk i mbeti gjë tjetër për të nxjerrë veç zorrëve. Mendimi i parë që i lindi ishte të vraponte në korridor, t’i telefononte shërbimit të urgjencës, të kërkonte ndihmë, në apartamentin e tij kishte ndodhur një aksident. Kështu bëri. Doli nga banja, vajti te telefoni varur mbi mur, mori receptorin dhe, çastin e fundit, kur deshi të formonte numrin e urgjencës, u paralizua. Përballë, fare pranë tij, sytë i zunë njërin nga portretet e biondes me syze. “Të kam thënë, i foli ajo, je i çmendur. Ti je i çmendur!”

Ai iu shmang. Dhe vuri re se ishte lakuriq. Po rrinte përpara biondes krejt lakuriq, i lagur, me shkumë dhe duar të përgjakura. “Ajo ka vdekur, e kotë t’i telefonosh urgjencës. Atë nuk ka urgjencë që ta ngjallë.” Ai ngriti kokën pa e kuptuar nëse këto fjalë i erdhën nga portreti apo i dolën së brendshmi. U kthye në banjë me shpresën e ndonjë mrekullie. Mbase vajzës i kishte rënë të fikët dhe, nga çasti në çast, do të zgjohej. Kjo shpresë iu shua sapo u fut në banjë: tjetrën e gjeti në të njëjtin pozicion, me sytë hapur, ngulur diku. E përfshiu një dënese. Dhe zuri t’i lutej vajzës të zgjohej. Sapo të zgjohej, ai do të dilte nga banja. Ajo do të lahej në qejf të vet, pastaj të kërkonte prej tij ç’të donte. Gjithçka kishte qenë një trill, ajo nuk mund ta dënonte kaq rëndë për shkak të një trilli.

Vajza nuk lëvizi. Megjithatë ai vazhdoi të dëneste duke iu lutur. Kur nuk pati më fuqi as të dëneste, as t’i lutej, e përshkoi një kthjellim. Të lajmëroj policinë, mendoi. Më tej e dinë ata. I qetësuar disi nga kjo zgjidhje, ndërsa tjetra dergjej e shembur pas bidesë, zbrazi ujin e vaskës dhe bëri një dush. Kujdesi për t’u larë i mori një kohë të gjatë. Ai nuk përdorte shampo, as për trupin, as për kokën. Përdorte vetëm sapun *Palmolive*. Sipas një zakoni të mbetur nga fëmijëria, kokën e sapuniste tri herë, trupin dy herë, me anë të një sfungjeri. Ai s’mund të thoshte për ç’arsye sapunistja e

kokës tri herë dhe e trupit dy herë ishte norma e detyrueshme për t'u konsideruar i larë. Kësaj radhe kjo normë iu duk e pamjaftueshme. Kishte një përshtypje të fortë sikur në trupin dhe duart e tij, sado t'i fërkonte, mbeteshin njollat e gjakut të vajzës. Doemos, ishte vetëm një përshtypje dhe, më në fund, ai doli nga vaska. Për të vajtur në sallon iu desh të kapërcente trupin e vajzës. Nuk e pati në dorë të mos i vështronte sytë e saj. Të shqyer, me vulën e llahtarit. Qetësia iluzive e pak çasteve më parë e braktisi dhe ai ra sërish pre e një ankthi të zi.

I mbështjellë me pelerinën-peshqir, në vend që të shkante te telefoni për të lajmëruar policinë, u shemb në kolltukun pranë tryezës. Vetvetiu dora i vajti te shishja. E mori, mbushi gotën e zbrazur, e ktheu, siç kthehet një gotë ujë... “Meqë nuk ta mban të thërrasësh policinë, përfundimi dihet, do të kalbesh në burg!”

Ai nuk e mori vesh nga i erdhën këto fjalë. Sidoqoftë, jo nga telefoni mbi mur, zilja e të cilit tringëlliu pikërisht në atë çast. E përshkoi një drithmë. U ngjesh pas shpinës së kolltukut, i alarmuar, me sytë mbërthyer te shishja dhe gota mbi tryezë, të dyja bosh. Zilja vazhdoi të tringëllinte, pesë, dhjetë, një mijë herë dhe pati një ngasje të sulej drejt aparatit, ta shqiste nga muri, ta përplaste përtokë. Ia doli të kryente diçka më të arsyeshme: rrëmbeu celularin mbi

tryezë dhe nga frika se mos tringëllinte edhe ai, e bllokoi. Pastaj gjithçka ra në qetësi. Ai mbeti në kolltuk, përballë zbrazëtisë së shishes dhe gotës, i pazoti të lëvizte, i paaftë të arsyetonte, të gjente një zgjidhje më të leverdishme sesa lajmërimi i policisë.

Pas dy-tri minutash, ndoshta pas dy-tri orësh, ai doli nga topitja. Prapa tij, në anën e kundërt të sallonit, përtej bibliotekës, që zinte një pjesë të faqes së murit, vinte bufeja. Në një nga të ndarat e saj, si kudo gjendej portreti i biondes me syze. Ai zgjodhi një shishe, gjithnjë *Jack Daniel's* dhe, para se biondja t'i fliste, u ngut t'i shmangej. Kishte nevojë të pinte, të rifitonte kthjelltësinë e trurit. Të shpëtonte nga ankthi i zi. Dhe, në njëfarë mënyre, ia doli. Si e çoi shishen në gjysmë, u ndie i qetë. Aq i qetë, sa e zuri gjumi. Derisa dikur u zgjua nga një gjëmim.

Sytë i hapi gati i trembur. Më shumë i befusuar: e mbështillte një errësirë e thellë. Përmes errësirës i mbërrinte në veshë zhurmë shiu. Ai lëvizi ngathtësisht në kolltuk duke ndjekur përplasjen e rrëmbyer të shiut në xhamat e dritareve. “Ç’mrekulli sikur të mos zgjohesha, mendoj, të mbetesha në terrin e hiçit! Si ajo debilja.”

Errësirën e çau një vetëtimë, që u pasua shpejt nga një gjëmim tjetër. Ai u shkund. I gjithë salloni kutërbonte. Dyshoi nëse

apartamenti mbante erën e rëndë të trupit të palarë të romes, apo trupi i saj i shembur në banjë, - s'mund të thoshte prej sa orësh, - për shkak të të nxehtit të ditës, që ia kishte lënë vendin një nate me rrebeshe, po qelbej. Pa ndezur asnjërën nga dritat, ai hapi dritaren. Me pelerinën krahëve, vajti në dhomën e gjumit, hapi edhe atje dritaren, veshi një bluzë, një palë pantallona xhins dhe ndezi për pak sekonda dritën e abazhurit mbi komodinën te koka e krevatit. Gjatë atyre sekondave vështroi orën: dhjetë e gjysmë. “Ka vetëm një zgjidhje, mendoi, të zhduk trupin.”

Ai fiku abazhurin, u kthye në sallon. Me hapjen e dritareve atje derdhej një ajër i freskët, i lagësht, që e kishte përzënë erën kutërbuese. “Është e pamundur që trupi i njeriut të prishet kaq shpejt”, mendoi. Dhe ndjeu se mund të arsyetonte. Çështja shtrohej fare thjesht: me pak kujdes, me pak fat gjithashtu, - rrebeshi i asaj nate ishte një ogur i mirë për të, - do t'ia hidhte. Nëse arrinte ta zbriste pa rënë në sy trupin e romes poshtë, - në parkingun prapa pallatit gjendej vetura e tij, - gjithçka mund të quhej e mbaruar. Ardhja e saj tek ai kishte qenë e rastit. Sipas fjalëve të saj, askush nuk e kishte parë të futej në pallat, të ngjiste shkallët dhe të trokiste në apartamentin e tij. Ata nuk njiheshin. Sido që të vinin punët, nëse ia dilte ta nxirrte nga shtëpia e ta linte diku, askush nuk kishte arsye për të bërë një lidhje midis tij

dhe kufomës. Ai dinte plot raste kufomash të gjetura nëpër kanale apo gjetiu, në shkallën më të skajshme të prishjes, braktisur nga vrasës të panjohur dhe të pazbuluar kurrë. “Edhe unë, tha me vete, ka të ngjarë të futem në kategorinë e vrasësve të panjohur.”

Këtë mendim deshi t’ia shfaqte biondes me syze, të cilën, për shkak të errësirës, nuk e shihte dot. Në vend të saj ia tha vajzës. “Po të të mbart deri te bagazhi i makinës sime pa rënë në sy, unë do të futem në kategorinë e vrasësve të panjohur. Ndërsa ti, debile, do të kesh rastin të bëhesh e njohur botërisht. Post mortum, siç thuhet, pas vdekjes. Për këtë të siguroj. Unë jam gazetar. Më saktë, kam qenë deri para ca muajsh, kur u prisha me atë bionden e fotografive.”

Ai u orvat dëshpërueshëm ta vishte viktimën me rrobat e saj. Punë jo dhe aq e lehtë. Më kot provoi t’ia mbyllte sytë. Më kot provoi t’i lëvizte krahët, t’i drejtonte trupin e përthyer, kokën e shembur pas bidesë. Për fat, nuk kishte shumë rroba për t’i veshur. I gjeti të hedhura në qoshe të banjës: një palë tuta ngjyrë blu, me shirita të bardhë anash. Një bluzë e kuqe me tri kopsa. Këpucë atlete të bardha. Çorape ngjyrë gri. Mbathje të zeza. Këmbët e saj kishin mbetur të hapura në një gjerësi që e bënte të pamundur kalimin e mbathjeve.

Tek i vishte fillimisht çorapet, sytë i vajtën sipër, atje ku njëra dorë e vajzës zgjatej te seksi,

të thuash se ishte përpjekur ta mbulonte, siç ishte përpjekur dora tjetër të mbulonte gjinjtë. “Debile, i foli, s’të mësova dot as emrin. Stërgjyshërit e tu mund të jenë me prejardhje nga Egjipti, mirëpo ti mban kryq, pra je e krishterë. Apo kryqin e mban kot? Po të pagëzoj, po të quaj Zhade. Aktualisht është emri më familjar te ne. Ajo biondja me syze e fotografive luante mendsh pas saj. Ndoshta ta kanë thënë të tjerë përpara meje: ti ngjan me Zhaden. Ç’dreqin pate që erdhe tek unë?”

Ai u orvat edhe një herë t’i vishte mbathjet, kësaj radhe duke gjetur një zgjidhje kompromisi: ia kaloi vetëm në një rën këmbë. Arriti t’i vishte edhe tutat, t’ia çonte deri sipër, afër kërthizës. Pas tutave, këpucët. Vajza nuk paraqiti ndonjë kundërshtim të madh për tutat dhe këpucët. Ajo kundërshtoi vendosmërisht kur ai u orvat t’i vishte bluzën. Me gjithë përpjekjet e tij, ajo nuk pranoi t’i lëvizte sadopak krahët, kështu që u detyrua të gjente sërish një zgjidhje kompromisi. Një rën dorë ia vuri në kokë, ia ngriti, me tjetrën ia kaloi bluzën në qafë, së prapthi. Mbeti i kënaqur, bluza mbuloi pak a shumë edhe fytyrën, edhe gjinjtë. Por ja nga përgjakja e dorës, ja nga kutërbimi i rëndë në banjë, vulli për së dyti. Nxori vrer, përzier me uiski. Kjo nuk e pengoi ta çonte fazën e parë të planit të tij deri në fund. Doli nga banja dhe, pa hapur asnjë dritë, vajti në dhomën e gjumit. Atje, në një musandër, mori një batanije, të

cilën e shtroi mbi dysHEME, pranë derës së banjës, prej nga nxori trupin e vajzës duke e tërhequr për këmbësh. E vendosi mbi batanije, e mbështolli në formë ruli dhe u pre: ishte njëlloj si të fshihte minaren në thes.

Zhurma e rrebeshit jashtë i kujtoi se, sidoqoftë, në atë natë të zezë kishte një aleat: shiun. Pas ndërprerjesh të herëpashershme, ai riniste inatçor, si të donte të zbrazte rrugët, t'i krijonte mundësinë për t'iu futur më i vendosur fazës së dytë të planit të tij, nxjerrjes së kufomës nga apartamenti.

Kurthi i parë e priste në korridor, për të vajtur tek ashensori. Këtë lëvizje mund ta kontrollonte duke përgjuar te dera dhe të dilte me ngarkesën e tij vetëm pasi të sigurohej se nuk do të ndeshte askënd. Sapo të dilte në korridor, punë sekondash, mbërrinte ashensorin. Me ngarkesën në krahë, kuptohet. Ajo s'duhej të ishte më shumë se pesëdhjetë kilogramë dhe, për shkak të përthyerjes së trupit, do ta hidhte në sup lehtësisht. Edhe po të ishte më e rëndë, fjala vjen, gjashtëdhjetë kilogramë, s'do ta kishte aq të vështirë sa ta mbartte deri tek ashensori, pastaj deri poshtë, në katin përdhes, e prej andej jashtë, në rrugë, dhe ta fuste në bagazhin e makinës. Për t'i kthyer shanset maksimalisht në anën e vet, do të duhej që, kur të dilte nga apartamenti, kabinën e ashensorit ta gjente lart, të hapur, makinën ta gjente gati, buzë trotuarit.

Nga ora dy e natës ai krijoi bindjen se ishte çasti më i përshtatshëm për të nxjerrë kufomën. Po rrinte në ballkon, i ngjeshur pas murit, duke përgjuar lëvizjet në rrugë. Ndërkaq, kishte bërë një banjë të dytë. Gjatë veshjes, më pas mbështjelljes me batanije të vazjës, ishte përlyer me gjak. Dhe tërë kohën i dukej se trupi i tij kutërbonte kalbësirë.

U shkëput nga qoshja e ballkonit dhe gjithnjë pa ndezur asnjë dritë, u orvat ta ngrinte trupin e mbështjellë me batanije në pozicion vertikal. Kjo doli një manovër disi e vështirë. “Zhade, u ankua, qenke plumb. Me siguri e ke kockën të rëndë.”

Në një kohë të dytë, nga pozicioni vertikal, ai e hodhi ngarkesën në sup. “Më vjen shumë keq për ty, i pëshpëriti. Mirëpo kështu qenkej thënë dhe së thënës nuk kemi ç’t’i bëjmë. Hollë-hollë, ti je më e fituar, i mbylle hesapet. Jeta që çoje, ma do mendja, nuk ishte jetë. Megjithëse s’kisha ndër mend të ta merrja, nuk më duhej jeta jote. Unë s’di ç’të bëj me timen.”

Sikur në ato çaste në sheshpushimin e katit të shfaqej dikush, ndonjë nga fqinjët e apartamenteve ngjitur ose ndonjë person tjetër i rastit, ai do ta linte veten në dorën e fatit. Madje me një lloj lehtësimi. Duket atë natë fati ishte i tëri në anën e tij, nuk deshë t’i nxirrte askënd. S’i mbeti gjë tjetër veç të shkonte drejt ashensorit. Kabina ishte ca e ngushtë dhe ai u rras skiç, bashkë me ngarkesën.

Në katin përdhes doli nga ashensori i qetë, po aq i qetë hapi derën e hyrjes së pallatit dhe u gjend mbi trotuar. Rruga e zbrazur lahej në shi. Në shi lahej edhe makina e tij, një BMW në ngjyrë të zezë. Ai nuk mori as mundimin të vështronte përreth. Nën shiun e dendur mbërriti te vetura. Hapi bagazhin dhe me ca lëvizje tërë përkujdesje, e vendosi ngarkesën brenda. “Këtu do të jesh mirë, i tha, nuk do të lagesh.”

Një copë herë qëndroi në këmbë, nën shi, në pritje që dikush t’i shfaqej. T’i thoshte: “Zotëri, loja juaj mori fund”. Askush nuk iu shfaq. Vetëm fjala “Pulëbardha” në krye të lokalit, hidhte në atë pjesë të rrugës një ndriçim të zbehtë. Ndoshta për këtë arsye atij nuk po i besohej se mund të zinte vend pranë timonit e të largohej. Në të vërtetë, kështu veproi, zuri vend pranë timonit, por nuk u largua menjëherë. Ndjeu një këputje të tmerrshme. Dhe, duke mbështetur kokën te timoni, mermëriti: “Zhade, ç’të bëj me ty tani, ku të të çoj?”

2.

T ë shkretët prindërit e mi! Vazhdojnë të banojnë në shtëpinë ku kam lindur unë, tridhjetë e dy vjet të shkuara, një apartament në katin e tretë të një pallati me çati, në një zonë dikur ndër më të lakmuarat e kryeqytetit. Ajo ndodhej jo shumë larg Bllokut, me ca rrugica të qeta plot gjelbërim, ku binin në sy drurët e mimozave, të cilat nuk guxonte t'i prekte njeri as kur lulëzonin. Veprimtarët e lagjes i ruanin nga keqbërësit me po atë vigjilencë që tregonin për të zbuluar mbi çatitë e pallateve ndonjë antenë televizori të drejtuar për të kapur valët e Rai-t. Ose të ndonjë stacioni televiziv jugosllav.

Prindërit e mi nuk ishin veprimtarë. Ishin shtetas të thjeshtë, të bindur. Ata nuk dilnin

me grupin e veprimtarëve për të kontrolluar antenat mbi çatitë e pallateve, ose në misione të tjera të këtij lloji, por zbatonin me përpikëri shembullore të gjitha udhëzimet. Fjala vjen, çdo të diel në mëngjes, ata dilnin të pastronin rrugicat rreth pallatit. Me raste, për të dëshmuar zellin e tyre, nuk mungonin të nxirrnin për pastrim edhe Anilën, motrën time, derisa kësaj i erdhi në majë të hundës, u bëri një skenë. I kërcënoi se po ta detyronin të dilte të dielave në punë vullnetare për të pastruar plehrat, do të shkonte të mbytej në liqen. Prindërit nuk duhet ta kenë besuar se Anila do ta realizonte kërcënimin, megjithatë u trembën. Ato kohë në liqen ishte mbytur vërtet një vajzë e lagjes, nuk u mor vesh për ç'arsye, qarkulluan lloj-lloj variantesh. Gjithsesi, arsyeja e mbytjes së saj nuk duhej të lidhej me detyrimin për ta prishur mëngjesin e së vetmes ditë pushimi të javës me punë vullnetare. “Në qoftë se ju keni vendosur ta ngrysnit jetën si skllëvër, më vjen keq, s’është në dorën time, por mua më lini të qetë”, e mbylli bllofin kërcënues Anila. Pas kësaj bombe, babai dhe nëna vështruan njëri-tjetrin. Fjala “skllëvër” duhet t’i ketë bërë t’u dridhen leqet e këmbëve. Ata nuk e detyruan më Anilën të dilte të dielave në punë vullnetare. Ajo nuk do të ngurronte t’ua përplaste përsëri atë fjalën e frikshme “skllëvër” dhe, meqë, siç besohej, edhe muret kishin veshë, fjala e rrezikshme mund të përcillej më tej, të shkonte te veshët e

veprimtarëve të lagjes, prej andej edhe më tej, e kjo do të thoshte të luaje me zjarrin.

Të shkretët prindërit e mi, nuk dëshironin të luanin me zjarrin. Ishin qytetarë të ndershëm, të bindur. Aq sa më vjen për të qarë!

Atëherë, nga fillimi i viteve '80 të shekullit të kaluar, isha i vogël, nuk e kuptoja ç'do të thoshte të luaje me zjarrin. Ato kohë unë vazhdoja të flija në një dhomë me prindërit, në një krevat prej druri, që tundej, i vendosur pranë shtratit të tyre bashkëshortor, nga krahu i nënës. Sipas llogarive të mia, prindërit më kanë mbajtur në dhomën e tyre të gjumit deri në moshën tetë vjeç. Moshë e njomë, por jo aq e pafajshme sa të mos kuptoja disa gjëra. Për shembull, kur prindërit bënë dashuri dhe unë shtiresha sikur flija.

Për ta sqaruar disi pse ata vazhduan të më mbanin aq gjatë në dhomën e tyre, në atë krevatin prej druri ku, përpara meje, kishte fjetur Anila, është e nevojshme të përshkruaj shtëpinë. “Pash Zotin, do të thoni ju, lërna rehat me gjithë shtëpinë. Ç'do të na thuash?” Keni të drejtë, shtëpia ku kam lindur unë nuk ishte ndonjë shato fisnikësh, as kështjellë princore, për të cilat ia vlen të flasësh. Megjithatë kërkoj ndjesë dhe leje. Tek ajo shtëpi nis dhe mbyllet gjithçka imja. Jashtë saj ndihem si një kërmill që ka dalë nga guaska, e ka humbur dhe përpiqet më kot ta rigjejë. Një kërmill në kërkim të guaskës së humbur.

Ishte një apartament standard, dy dhoma e kuzhinë. Dhoma të zakonshme, relativisht të larta krahasuar me dhomat e apartamenteve ku jetonin shokë të mi në lagje të tjera, në pallate ndërtuar më vonë se ata të zonës ku banoja unë, e që i quanin “kuti shkrepësesh”. Ndërsa dhomat ishin pak a shumë të pranueshme, kuzhina ishte mirëfilli një kuti shkrepësesh. Korridori edhe më i ngushtë. Banja po ashtu. Po të mos përmend bodrumin. Të gjitha pallatet e zonës sonë, dy dhe trekatësh, ndërtuar me tulla të kuqe, të pasuvatuar, kishin bodrume dhe çdo familje zotëronte të vetin. Siç kishim edhe ne tonin. Në adoleshencë unë rrija shpesh atje, arratisesha.

Nëse bodrumi ishte për mua një hapësirë lirie, në shtëpi ekzistonte një hapësirë e shenjtë: dhoma e pritjes. Dikur prindërit nuk mbanin atje ndonjë ikonë të mirëfilltë, siç mbajnë sot. E them që në krye, prindërit e mi janë besimtarë. Këtë fakt e kam mësuar vonë, në epokën moderne, kur ata nuk patën më frikë ta fshihnin. Dhe zunë të shkonin në kishë, të ndiznin qirinj, të ndiqnin ceremonitë, dhe në dhomën e pritjes ekspozuan një ikonë të shën Mërisë, relike e familjes së tim eti, që kishin mundur ta fshihnin një jetë të tërë. Në epokën paramoderne, ose parahistorike, quajeni si të doni, për të larguar syrin e të ligut, - nuk përjashtoj mundësia që i ligu të depërtonte edhe në shtëpinë tonë, - te dhoma e pritjes,

në vend të shën Mërisë, ata mbanin ikonën zyrtare.

Kur linda unë, Anila ishte plot tetë vjeç. Shpesh kam vrarë mendjen të gjej për ç'arsye prindërit më sollën në jetë pas një pushimi prej tetë vjetësh. Mirëpo në këtë botë punët kështu u rregullokan! Ndryshe, sikur në riprodhimin e species njerëzore të merrej edhe mendimi i atyre që thirren të luajnë një rol të mëtejshëm, unë nuk do të kisha pranuar të vija në jetë, aq më pak tetë vjet pas motrës. Do ta kisha kundërshtuar në mënyrë kategorike idenë e prindërve lidhur me mua, nëse ata kanë pasur vërtet një ide, dhe përjashtojmë një gjasë po aq të natyrshme, që ardhja ime të ketë qenë aksidentale, pra as e menduar, as e dëshiruar. (Nuk e di dhe nuk do ta mësoj kurrë: a shtirej Anila sikur flinte në kohën që prindërit më ngjiznin në errësirën e dhomës?) Një gjë është e sigurt: mua nuk më pyetën, doja apo nuk doja të vija në jetë. Askush nuk na pyet për këtë. Askush nuk është pyetur, as do të pyetet ndonjëherë. Na merren të drejtat nëpër këmbë qysh përpara se të lindim.

Të shkretët prindërit e mi! Po t'ua shfaqja këto mendime, do të luteshin për mua.

Me ardhjen time arbitrare në jetë, me përjashtim vetëm të dy netëve, Anila vazhdoi të flinte në kuzhinë. Them kuzhinë! Unë nuk mbaj mend që ajo kthinë e vogël të jetë përdorur

mirëfilli si e tillë. Aty kishte një tryezë, dy karrige, një sobë nga ato me dru, një kambalec mbi të cilin ndodhej televizori dhe një divan. Vendosja e këtij të fundit ishte bërë e mundur pas një modifikimi. Disa muaj para lindjes sime, korridorit i qenkej marrë një gjerësi prej nja dy pëllëmbësh. Njëkohësisht, lavapjata qenkej shpërngulur nga kuzhina në banjë, përbri lavamanit. Hapësira e përftuar kështu solli një lloj zgjerimi të kuzhinës dhe mundësoi vendosjen e divanit ku, me një ndërprerje prej vetëm dy netësh, Anila fjeti derisa u martua dhe vajti te burri. Gjatë gjithë kësaj periudhe unë fjeta në hapësirën e shenjtë të shtëpisë, te kanapeja e dhomës së pritjes.

Ç'është e vërteta, kur mbusha tetë vjeç, m'u tha se tash e tutje do të flija në kuzhinë, te divani. Ky njoftim nuk më erdhi i papritur. Fjetja në një dhomë me prindërit më ishte kthyer në torturë. Duhet të kem qenë në klasën e dytë fillore dhe, ndërkaq, në biseda me moshatarë të mi, unë mbroja një tezë hyjnore: të gjithë ne kishim lindur nga sjetulla e nënës. Disa të paktë e mbështesnin tezën time hyjnore. Shumica talleshin. Me sa mbaj mend, jam tronditur kur dëgjova një fakt turbullues: ne nuk dilnim nga sjetulla e nënës. Dilnim nga një organ, emrin e të cilit e përmendnin rrugaçët në sharjet e tyre. Më tronditësja: për të lindur ne, babai dhe nëna bënë dashuri. Djemtë nuk thonin "bëjnë dashuri". Përdornin

atë fjalën e quajtur të ndyrë, që i përkiste fjalorit të rrugaçëve. Këto më mundonin. Në sytë e mi prindërit ishin qenie ideale. Prindërit e të tjerëve ndoshta e bënë atë punën që shprehej me foljen e ndyrë përkatëse të rrugaçëve, por të mitë, jo! Ata vetëm sa flinin bashkë në një krevat, pranë njëri-tjetrit, dhe s'mund të kryenin veprime të turpshme. Derisa një natë, s'di sesi, më doli gjumi dhe dëgjova rënkime. Mbajta frymën pa guxuar të lëvizja, pa guxuar të hidhja vështrimin përtej krevatit. Rënkimet vazhduan për njëfarë kohe në errësirë, pastaj gjithçka ra në qetësi. Raste të tilla të daljes së gjumit u përsëritën. Dhe një natë s'durova dot më. “Çfarë po i bën mamit, o babi?”, thashë. Ata nuk m'u përgjigjën, heshtën për një kohë të gjatë. Më në fund, te veshët e mi mbërritën ca pëshpëritje, një si e qeshur dhe zëri i nënës. “Fli, tani, foli ajo, fli!”

Shpërngulja ime nga krevati prej druri i dhomës së prindërve, te divani në kuzhinë, u krye të nesërmen. Mirëpo vetëm pas dy netësh, m'u komunikua vendimi i ri: do të kaloja nga divani në kuzhinë, te dhoma e pritjes.

Nuk u bëra kureshtar të mësoja shkaqet e kësaj shpërnguljeje të beftë. Mjafton që s'flija më me prindërit. Për më tepër, fjetja në kuzhinë doli për mua gjithashtu një lloj torture: atje gjendej televizori. Anila këmbënguli ta merrte edhe televizorin me vete, por prindërit

nuk i hapën rrugë. Të shkretët! Po të mos ua kisha drejtuar pyetjen fatale, kushedi edhe për sa kohë do të më mbanin në dhomën e tyre. Tani u duhej të bënin një sakrificë të jashtëzakonshme, të cenonin paprekshmërinë e hapësirës së shenjtë. Ndërsa Anila kërkonte të merrte me vete televizorin! Jo, ata s'mund të lëshonin kaq shumë. Hapësira e shenjtë do të degradonte, do të kthehej, siç u shpreh im atë, në sallë kinemaje.

Anila nuk duroi te dhoma e pritjes më shumë se dy net. Këtë e shpjegova me televizorin. Kur prindërit largoheshin pas emisionit të fundit të lajmeve, ajo rrekej të kapte ndonjë stacion të huaj, me kanoçe. Kjo mund të ketë qenë një nga arsyet përse ime motër, ato kohë në klasën e dytë apo të tretë gjimnaz, kërkoi të kthehej përsëri aty ku kishte fjetur për tetë vjet radhazi, te divani në kuzhinë.

Sipas meje arsyeja duhet të ketë qenë një tjetër. E kam fjalën për diçka tepër të veçantë. Për zbulimin fatal të jetës sime: një kor. Unë e quajta Kori i Krimbave, pa kurrfarë kuptimi metaforik. Truri im s'mund të ndërtonte metafora dhe, kur e dëgjova këngën e tyre, u magjepsa. Në fillim i mora për krimba të zakonshëm, nga ata të tokës, që dalin në sipërfaqe pasi bie shi, ose i mbledhin peshkatarët buzë pellgjeve për karrema. Gabohesha, ishin krimba të një lloj tjetër. Aktualisht ata më interesojnë shumë por, ju

lutem, më lejoni të hap më parë një parantezë.

Shpall botërisht se prindërit e mi janë martuar me dashuri. Shpresoj t'u bëhet qejfi nga ky njoftim dhe të më falin për hollësitë e pakëndshme nocturne që përmenda më sipër, ose të tjera, për shembull, kur visheshin e zhvisheshin në dhomë faqe meje. Në ngushticën e lumtur të jetës sonë kjo ishte normale. Aq normale, po them, sa zierja e gjellës në banjë. Mbi ato furnelat me vajguri, duhet t'i mbani mend, s'ka kaluar ndonjë kohë e gjatë sa të mos i mbani mend, në rastin më të mirë të vendosura në një kamare të hapur posaçërisht në faqe të murit, në rastin më të zakonshëm të vendosura përtokë, në një qoshe të banjës, si rregull allaturka. Nëna ime i përkiste rastit më të mirë, do të thoja të mirit fare. Kamarja e furnelës me vajguri në banjën tonë ishte relativisht e lartë, relativisht e thellë, veshur me pllaka majolike të bardha, komunikonte me oxhakun, përmes të cilit kryhej largimi i gazrave. Dy kanate prej qelqi të trashë, mbërthyer në korniza metalike inoksidabël, që hapeshin e mbylleshin, e izolonin nga pjesa tjetër e banjës. Një vepër arti! Nëna nuk linte rast pa ua demonstruar me mburrje vizitoreve, që nga komshiet, deri te kushërirat, të afërta e të largëta. Sa për pjesën tjetër të gazrave, që çliroheshin nga gryka e WC-së, ato largoheshin jashtë përmes një dritareje të vogël, shumë të vogël, në përputhje me përmasat prej kutie

shkrepësesh të banjës. Kjo dritare rrinte vazhdimisht e hapur. Në çdo kohë, brenda nuk vinte as erë WC-je, as erë gjellësh. Pra, kombinimi banjë-kuzhinë në shtëpinë tonë ishte i përsosur, mund t'u shërbente amvisave shqiptare si model, si novacioni më i arrirë për shfrytëzimin racional të asaj hapësire shtëpiake në funksionin e dyfishtë banjë-kuzhinë.

Histori e harruar. Dhe më vjen keq. U nisa t'ju flas për martesën dashurore të prindërve të mi, ndërsa rrugën ma zënë subjekte të tilla mediokre. Për më tepër, Zot na ruaj, mund të lëndojnë, në mos sedrën tuaj, sedrën e s'di se kujt. Po ngrihem një shkallë më lart, siç e meriton lidhja dashurore e prindërve të mi. Me një zbulim tjetër të epokës, kësaj radhe as fatal, as metaforik. Gjithsesi, shpresoj të mos e fusni te mediokritetet e jetës.

Kur bridhja me shokë përtej lagjes sonë, ndodhte të kaloja para një godine të vjetër dykatëshe me çati, suva të rënë dhe arkitekturë të ndryshme nga ndërtesat rreth saj, e stilit gotik, me një oborr ku gjithmonë shihja plaçka të varura në tel. Po aq shpesh kaloja para një godine tjetër, më të madhe, më të lartë, kati përdhes i së cilës, deri vonë, shërbente si farmaci. Nuk e kam ditur se fati ynë flinte në themelet e tyre. Një ditë të bukur ne e pamë veten zotër të atyre godinave leproze, që befas u shfaqën si margaritarë në zemër të kryeqytetit: ishin pronë e familjes

së tim eti, të shtetëzuara pas Luftës së Dytë Botërore të shekullit të kaluar. Gjyshi im nga babai, një tregtar i pasur, vdekur në kohën e atyre që kam dëgjuar të quheshin tatime të jashtëzakonshme, paskej qenë pronar i godinave në fjalë. Dhe pronash të tjera. Rrjedhimisht, ato u përkisnin pasardhësve të tij. Dhe pasardhësve të pasardhësve të tij. Por, edhe ky episod, megjithëse, kuptohet, s'mund të konsiderohet mediokër, nuk përmban asgjë romantike për lidhjen e prindërve të mi. Diçka më romantike, pra!

E përfytyroj tim atë me kasketën e tij të përjetshme. Dhe mustaqet po aq të përjetshme, në një fshat ku të gjithë e dinë se i përket kategorisë së të deklasuarve. Në kohën që im atë, i gjatë e i hollë, pothuajse simpatik, kryente detyrën e veterinerit në një fshat ku të gjithë e dinin se i përkiste kategorisë së të deklasuarve, nëna ime gjendej në po atë fshat, mësuese e fillores. Ajo nuk i përkiste kategorisë së të deklasuarve. I përkiste një kategorie tjetër, për të cilën s'di të ketë ndonjë term përcaktues. Nëse formalisht kërkojmë një analogji me termat e njohura të politikës së sotme, them se nëna i përkiste kategorisë që cilësohet me termin idiot *pozitë*. Prandaj unë kam menduar gjithmonë se marrëdhënia dashurore midis prindërve të mi duhet të ketë qenë diçka romantike. Këtë e vërteton edhe një fakt tjetër, që ashtu si ekzistencën e ikonave,

e kam mësuar vonë. Im atë ka shkruar gjithë jetën vjersha. Ka qenë, siç thuhet, vjershëtor. Me një lexuese të vetme: nënën time.

E mbaj mend tek lexonte, - në dhomën tonë të pritjes, mbështetur pas një rës prej faqeve të murit gjendet një bibliotekë e rëndë, me sirtarë e të ndara mbushur me libra, - dhe shpesh ulur pranë tryezës, duke shkruar. Nuk e dija çfarë shkruante. Që shkruante poezi e mësova rastësisht, kur isha student, në vitin e parë të fakultetit, duke rrëmuar sirtarët e bibliotekës. Në njërin prej tyre, një ditë gjeta fashikujt e një libri të vjetër, në format relativisht të madh, me ilustrime bardhë e zi: romanin “Konti i Montekristos”. Brenda fashikujve zbulova një vjershë, shkruar mbi një fletë fletoreje, e para dhe e fundit që kam lexuar nga krijimet e tim eti. Vjersha përmbante katër strofa. Dhe nënshkruhej Kiço Terziu, 1957. Im atë quhet Kiço Terziu. Meqë është i datëlindjes 1934, del se kur e ka shkruar, ka qenë njëzet e tre vjeç. E pyeta nëse ishte vërtet autor i saj. “Gjepura”, më tha.

U kujtova! Nëna i përkiste kategorisë familje dëshmori. Një vëlla i saj, më i madhi i fëmijëve, emrin e të cilit e mban një shkollë, është vrarë në moshën katërmëdhjetë vjeç, pak përpara mbarimit të Luftës së Dytë Botërore të shekullit të kaluar. Në rrethin familjar të nënës ka edhe dëshmorë të tjerë. Një vajzë në kushtet e saj mëkatonte rëndshëm po të binte në dashuri

me një djalë në kushtet e tim eti, edhe nëse ky ishte gati simpatik dhe shkruante vjersha.

Po ç'dreqin kërkoj duke zhbiruar në këtë histori të vjetër? Ajo mund të më fusë në udhë pa krye. Më keq: ka të ngjarë të ngacmoj plagë të mbyllura. Unë s'dua të ngacmoj plagë, as të mbyllura, as të hapura. Të shkretët prindërit e mi! Kanë qenë të braktisur edhe nga njerëzit më të afërt për shkak të deles së zezë: tim eti. Por këto tashmë janë kapërcyer. Një ditë dyert u hapën, nëna u ripranua në tufë. Bashkë me delen e zezë. Dhe me pjellën e tyre, Anilën. I futën brenda vathës. I rregulluan me shtëpi në Tiranë, në apartamentin ku thashë se kam lindur tridhjetë e dy vjet të shkuara. Ku ata vazhdojnë të banojnë, dhe unë shkoj t'i shoh, me raste. Dhe sa herë që vete atje, më bëhet sikur dëgjoj korin, atë Korin e Krimbave në dhomën e pritjes. Zbulimi fatal i jetës sime.

Unë e kuptova shpejt përse Anila nuk pranoi të flinte në hapësirën e shenjtë të shtëpisë më shumë se dy net. Kjo e fundit ishte ende në gjendjen e saj fillestare: një dhomë e rëndomtë, që përfundonte me ballkon, nga ata të futur brenda, në formë lozhe. Kur më vendosën për të fjetur atje, ballkoni vazhdonte të shërbente si ballkon, kishte disa saksi me lule, asgjë tjetër. Në verë, prindërit nxirrnin karrige, uleshin dhe pinin kafe. U pëlqente të dilnin sidomos në muzg, vështronin kalimtarët poshtë, dhe

fqinjët në ballkonet e pallateve përballë, me të cilët na ndante një fushë pjesërisht e mbuluar me bar, pjesërisht me ferra. Kishte një kumbull dhe një pikë për kazanë plehrash. Kazanë plehrash kishte edhe në anën e kuzhinës dhe, të shkretët prindërtit e mi, e vuajnë edhe sot e kësaj dite këtë fakt.

Është gjetur, - kam përshtypjen se do të gjendet gjithmonë, - një i fantaksur që t'u vërë zjarrin kazanëve të plehrave. Dikur piromani njihej, ishte një djalë në moshën e Anilës, e quanin Lloni. Ky nuk e çante kokën për askënd, e kotë t'i flisje, t'i thoje të mos ua vinte zjarrin kazanëve. U bindej vetëm veprimtarëve të lagjes. Jo se këta i bënë ndonjë gjë. Po ta rrihnin, çka edhe ndodhte, Lloni s'pyeste. Ai tmerrohej kur e kërcënonin se po t'ua vinte zjarrin kazanëve, babanë e tij do ta fusnin në burg. Kërcënimi nuk kalonte pa lënë gjurmë dhe Lloni binte për ca kohë në qetësi. Pastaj, papritur, ndonjë mëngjes herët, më shpesh ndonjë mbrëmje, banorët e pallateve përreth mallkonin piromanin: nga kazanët ngriheshin drejt qiellit shtëllunga tymi, njerëzit linin ballkonet, mbyllnin dritaret. Sot Lloni ua ka mbathur, ka ikur në Greqi. Ndoshta e ushtron zanatin e tij atje, mirëpo kazanët e plehrave vazhdojnë të digjen periodikisht. Dhe s'dihet kush ua vë zjarrin.

S'ka pikë rëndësie, jam i një mendjeje me ju. Për më tepër, prindërit e mi nuk dalin më

të rrinë në ballkon. Ata kanë kohë që s'dalin më të rrinë në ballkon, sepse ballkoni nuk ekziston më. Qysh se dhoma e pritjes pushoi së qeni një hapësirë e shenjtë. Dhe për mua, pushoi së qeni një hapësirë e magjishme. Unë zbulova atje një magji, të cilën Anila mundi ta duronte vetëm dy net. E kam fjalën për Korin e Krimbave.

Natën e parë që fjeta në dhomën e pritjes, dëgjova vetëm një zë. Ai ndodhej fare pranë meje, i fshehur në skeletin e drunjte të kanapesë. Nëna më mbuloi me jorgan, më pyeti në kisha frikë të flija vetëm, pyetje e kotë, unë e kisha provuar dy net radhazi në kuzhinë që s'kisha frikë. Ajo mbylli dritën, doli nga dhoma dhe unë u zhyta në errësi. Pastaj sytë m'u mësuan, zura të dalloja sendet: një tryezë rrumbullake, e ulët, në mes të dhomës. Dy kolltukë me susta pothuaj të prishura, me mbështetëse anësore të drunjte. Një bufe në anën e kundërt të kanapesë, më këndeje, dhe dy pupe të vogla. Pa llogaritur bibliotekën në faqen tjetër të murit. Ky ishte kompleti i mobilieve të dhomës së pritjes, veshur i tëri me stof ngjyrë vishnjë, vende-vende të ngrënë.

Dikur ai kishte mobiluar një tjetër dhomë pritjeje, në shtëpinë e fëmijërisë së tim eti. Tani ndodhej këtu si e vetmja mbeturinë e një bote të varrosur. Atë natë, kur nëna mbylli dritën dhe doli nga dhoma, unë nuk isha i aftë të ngrihesha tek abstragimi “botë e varrosur”.

Për mua kishte vetëm një botë, në përmasat e një kutie shkrepësesh, që u pasurua me një element të ri. Po përgjoja errësirën, pa mundur të flija, kur ndjeva një si brejtje: kërc-kërc-kërc. Mbajta frymën, u bëra i tëri vesh. Unë ende nuk e dija ç'ishin krimbat e drurit. Dhe s'mund të them se kur dhe nga kush mësova një veti të tyre. Krimbat e këtij lloji janë shenjë e prishjes. Pas dyzet ditësh në varr, trupi i njeriut, thonë, zë krimba. Atë natë, kur ndjeva gërvishtjet fare pranë veshit tim, unë s'isha në gjendje të gjeja një ngjashmëri midis trupit të një njeriu të vdekur, që e brejnë krimbat në varr, dhe trupit të mobilieve të dhomës sonë të pritjes, me të cilat po ndodhte afërsisht e njëjta gjë. Aq më pak të shkoja më tej. Ta vija veten në rolin e dëshmitarit të grahmave tragjike të mbeturinave të një bote të varrosur.

Një copë herë përgjoja të gjeja vendin prej nga vinin brejtjet. Nuk m'u dukën as grahma, as tragjike. Përfytyrova diçka më të thjeshtë: një qenie kërkonte të lidhej me mua. Të komunikonte. Ndërkaq përcaktova vendndodhjen e saj, te pjesa e drunjtë e kanapesë, sipër kokës sime, dhe zgjata dorën ta prekja. Qenia heshti. Ajo zuri të më dërgonte përsëri mesazhe pasi e tërhoqa dorën. Tek rrija në errësirë duke u përpjekur t'u gjeja një kuptim mesazheve, më kaploi një përhumbje. Në atë përhumbje, brenda meje u ngrit një melodi. Sot do të thoja e kënduar me zë tenori.

Me radhë, natë pas nate, e vunë në dukje praninë e tyre krimbi bariton, në mbështetësen e drunjtë të njërit prej kolltukëve, krimbi bas, në mbështetësen e drunjtë të kolltukut tjetër, në fund më i veçanti, krimbi travesti, diku, në pjesën e poshtme të bibliotekës. Anila, mendoj, duhet të ketë ikur nga dhoma e pritjes për shkak të tyre. Mundet t'i jenë shfaqur të tre bashkë. Por mundet t'i jenë shfaqur në duet, solo apo trio. Më mbetet vetëm një dyshim: a e ka dëgjuar vërtet korin e tyre Anila? Nuk ia drejtova ndonjëherë këtë pyetje. Për Korin e Krimbave i kam folur më vonë vetëm një njeriu: Veronikës.

3.

Katër ditë radhazi nuk pati asnjë lajm, në asnjë gazetë, në asnjë kanal televiziv. Ai nuk e priste një heshtje kaq të gjatë. Në krye të katër ditëve i erdhi të besonte se nuk kishte ndodhur asgjë, gjithçka kishte qenë një ëndërr e keqe.

Ai vuajti tmerrësisht vetëm një ditë, të nesërmen. Në shtëpi u kthye ndaj të gdhirë, i rraskapitur dhe tërë kohën e kaloi i mbyllur brenda, duke pirë. Duke larë e duke fërkuar pllakat e banjës. Sikur atje të mbeteshin vazhdimisht njolla gjaku. Afër mbrëmjes, ia doli t'i përzinte fantazmat e frikës. “Në banjë s’ka dhe s’mund të ketë njolla gjaku, mendoi. Asgjëkundi s’ka më njolla gjaku. Logjikisht jam jashtë çdo dyshimi, pra jashtë çdo rreziku.”

Ky arsyesim i krijoi një ndjesi të përafërt me epërsinë ndaj botës. Tashmë mund të quhej kriminel. Një vrasës, të cilit, herët a vonë, do t'i qepeshin këmba-këmbës. Do të niste gjuetia, komuniteti do të bënte çmos ta zbulonte, t'i vinte një emër. Por, për paradoks, ai, kriminelin anonim, gjendej i ulur në një fron, shumë lart. Prej andej mund të sodiste marrëzinë dhe ligësinë njerëzore. Të luante me to.

Truri i tij u godit nga një ide. Gjeniale, do të thoshte. Për pak sa nuk doli në ballkon. T'u ulërinte njerëzve: "Hej, mjeranë të mefshtë. Unë, kriminelin i fshehur, kam një ide gjeniale!"

Sigurisht, nuk e ndërmoi një veprim të tillë. Loja duhej të niste natyrshëm. Në formën e një rikthimi të heshtur nga bota e të vdekurve në atë të të gjallëve dhe porta përmes së cilës duhej të kalonte për t'u rikthyer, ishte Dina.

Të nesërmen në mëngjes, tingujt e lehtë të një muzike e zgjuan në orën shtatë e tridhjetë minuta. Sytë i vajtën te portreti i biondes mbi komodinë. Më kot shpresoi që ajo t'i thoshte diçka, biondja nuk i foli.

Pas një dushi të shpejtë, u vesh. Doli nga apartamenti, mori ashensorin dhe në orën tetë e pesëmbëdhjetë minuta zuri vend në tryezën e tij të përhershme te "Pulëbardha". Qelqi i errët i faqes ballore e bënte misterioz shkëlqimin e atij mëngjesi. Njëherazi i krijonte siguri: nuk lejonte kalimtarët mbi trotuar të shihnin

brenda, ndërsa ai vetë mund të përqendrohej në fytyrat e tyre pa u shqetësuar. Kjo vazhdoi derisa Dina mbërriti pranë tij, i vuri përpara të zakonshmet: kafënë, ujë mineral pa gaz, dhe një gotë me *Jack Daniel's*. “Dje nuk je dukur gjithë ditën, vërejtë ajo. Të mora edhe në telefon. S’ke qenë në shtëpi?”

Ai ngriti kokën. Do të kishte dashur t’i parashtronte asaj diçka lidhur me idenë e tij gjeniale, që lind vetëm nëse ke fatin të rikthehesh në banalitetin e botës pas një udhëtimit në kufijtë e jetës me vdekjen. Ku ndihesh edhe i gjallë edhe i vdekur, siç po ndihej ai në ato çaste. Në vend të këtyre, i tha: “Sot je bërë e mrekullueshme, të dëshiroj qenërisht. Dhe shtoi: Eja, ngjitemi lart, që tani...” Ajo ngurroi. Në sytë e tij kapi atë xixëllimin e veçantë, që ndonjëherë i fuste frikën. “Tani është e pamundur”, ia ktheu. Dhe duke u skuqur, - ai xixëllim e eksitonte, - mërmëriti: “po të duash vij pasdite, me të lënë turnin...” “Dakord, tha ai, me të lënë turnin.”

Zonjusha u tregua e përpiktë. Tek ngjitej me ashensor për në apartamentin e tij, ajo e përfytyroi ç’do të ndodhte. Kur ai “e dëshironte qenërisht”, tregohet i paduruar. Sapo ajo futej brenda, e përfshinte në krahë, e çonte në dhomën e gjumit. Atje e zhvishte si ndër ethe, ndodhte t’i këpuste rripat e këmishës. Këtë egërsi ajo e pranonte. Kishte pasur gjithsej tri përvoja të tjera seksuale dhe tani po e kuptonte

mirëfilli se ç'do të thotë të ndihesh seksualisht e poseduar. Në këtë pikëpamje partnerët pararendës nuk i vinin as te thoi i këmbës partnerit të ri. Jo vetëm në këtë pikëpamje. Përtej egërsisë seksuale, partneri i ri ishte një qenie e butë. Madje, një kuzhinier i shkëlqyer. Ai dinte të përgatiste lloj-lloj pjatash dhe, pas seksit të stuhishëm, kjo ishte për të një tjetër kënaqësi e paprovuar më parë. Kështu që tek ngjitej drejt apartamentit, ndihej e ndezur.

Fillimi nuk doli dhe aq premtues. Ajo shtyu derën dhe mbeti në prag: ai jo vetëm nuk po e priste ta merrte në krahë, por nuk ndodhej fare në sallon. E zhgënjyer disi, mbylli derën pas vetes, hodhi disa hapa dhe thirri: “Bledi, ku je fshehur?” S’mori përgjigje. Shaka të tilla nuk ishin në natyrën e partnerit. “Bledi”, thirri përsëri dhe përsëri nuk mori përgjigje. Atëherë i mbërriti zhurma e lehtë e kërcitjes së tasteve të një kompjuteri. Kjo i dha të kuptonte se ai duhej të ndodhej në studion e tij, një dhomë e vogël, e fshehur pas një korridorit, në fund të sallonit. Ishte futur atje njëherë të vetme, për të parë, ndonëse s’kishte ndonjë gjë të madhe për të parë: një tryezë mbi të cilën gjendej kompjuteri, ca aparatura të tjera, një karrige veshur me lëkurë të zezë, e rrotullueshme dhe, si kudo, portreti i biondes me syze. Dy faqe të studios, nga dyshemeja në tavan, ziheshin nga rafte të mbushura me libra. Iu desh të qëndronte një copë herë në këmbë para se ai

të kthente kokën, ta ftonte të ulej, - në studio nuk kishte asnjë karrige ku të ulej, - e t'i drejtonte një pyetje të çuditshme: a ndiente erë të keqe?

Vetvetiu vështroi përreth. “Jo, iu përgjigj, s’vjen erë e keqe.” Dhe deshi të shtonte: Pse duhet të vijë erë e keqe? Fjalët iu lidhën në fytyrë. Ja ngase iu dukën të pakuptimta, ja ngase pikërisht kur po i humbiste shpresat për një pasdite të stuhishme, ai i vajti pranë. E zuri nga supet dhe i shfaqti një kërkesë të papritur: “dua ta bëjmë në vaskë”, i tha.

Në vështrimin e tij u duk xixëllimi i njohur turbullues. Nga përvojat e saj ajo kujtonte seks në natyrë, në këmbë, mbështetur pas tringut të një peme, ose shtrirë rrëzë ndonjë gëmushe. Seks në makinë në ndenjësën e pasme. Seks në karrige, mbi një tryezë dhe, doemos, seks në shtrat, në një dhomë hoteli. Por asnjëherë seks në vaskën e banjës.

Duhet të jetë bukur, mendoi, tek rrinte ulur në kolltuk, pranë tryezës së vogël të sallonit, e zhveshur, mbështjellë me një pelerinë-peshqir, në pritje që ai, siç i kishte thënë, të bënte banjën gati. Kur e thirri dhe ajo e gjeti të zhytur në vaskë, mbase do të kishte formuluar një kompliment. T’i thoshte: Je i madh. Të pish shampanjë është një ide e mrekullueshme. Mirëpo ai i drejtoi një pyetje pa kurrfarë lidhjeje me shishen e shampanjës dhe dy gota, që ia zunë sytë mbi ndenjësën prej plastmase të

banjës. I drejtoi po atë pyetje idiote. Pra, a ndiente ndonjë erë të keqe?

Ajo mendoi se ai po tallej. Nuk ishte në natyrën e tij të tallej. Sipas saj, ai nuk e kishte dhe aq të zhvilluar sensin e humorit. “Është hera e dytë që ma drejton këtë pyetje, i tha. Nëse je penduar që më ftove, po largohem.” Tjetri e vështroi i përhumbur. “Jo, i tha gati me lutje, mos ma vër re. Jam shumë nervoz sot, kupton?” Ajo nuk kuptoi gjë, por, sidoqoftë, për t’i dëshmuar se në reagimin e saj s’kishte ligësi, hoqi pelerinën, e vari në mur dhe, duke u kujdesur të mos rrëshqiste, u fut në vaskë. “Gjej diçka më të bukur se shakaja me erën e keqe”, i tha.

Ai nuk ia përmendi më atë që ajo e quajti shaka me erën e keqe. Katër ditë fluturuan njëra pas tjetrës, të mbushura me një ankth pritjeje dhe seancat e seksit në vaskë. Mëngjeseve zgjohej në orën shtatë e tridhjetë minuta. Nja treçerek ore më vonë gjendej poshtë, te “Pulëbardha”. Derisa ia mbërrinte Dina me kafënë, ujin mineral dhe gotën e uiskit, ai shihte kalimtarët përtej xhamit blu dhe, kur mbërrinte ajo, i shpallte deklaratën provokative: “të dëshiroj qenërisht!” Tjetra e përjetonte me një konkretësi pështjelluese këtë deklaratë. Disa klientë, - ata vinin në lokal për të, - më kot orvateshin t’ia prishnin mendjen. Një shqisë e pagabueshme e pajiste

me informacionin e duhur: ata nuk vlenin një grosh krahasuar me partnerin e ri.

Mirëpo në sflitjen seksuale të atyre ditëve asaj i ranë në sy ca ndryshime në sjelljet e tij. Fjala vjen, përveç uiskit të mëngjesit, ai s'pinte më. Nuk i rastisi më ta shihte në tryezën e sallonit, ulur në kolltuk, me shishen përpara. Kishte gjetur një mënyrë tjetër për të kaluar kohën: rrinte me orë në studio, duke punuar në kompjuter. Nuk mund të mos i binte në sy edhe një fakt i ri: ai zuri të tregonte interes të papritur për gazetat. Dhe për emisionet e lajmeve në televizion. Mëngjeseve, kur i shërbente kafenë dhe uiskin, e gjente në tryezën e tij me disa gazeta, të cilat i blinte te një kioskë në kryqëzimin aty pranë. Deri atëherë, kur binte fjala më të rrallë për gazetat, ai shprehej me përbuzje. Dhe e lavdëronte që ajo nuk rradhitej në falangat e ngrënësve të gazetave. Tani po kthehej vetë në ngrënës gazetash.

Vargu i këtyre ndryshimeve mbyllej me një hollësi të fundit. Nëse do të ishte naive si mikësja e saj e syzeve optike, që i rrëfente çdo aventurë të re, këtë hollësi të fundit ajo do t'ia përshkruante pak a shumë kështu: “më ra në sy kur u orvatëm të bënim seks në vaskë për herë të parë. Them u orvatëm, sepse doli një dështim. Unë ndihesha jo aq në formë nga ca sjellje të tij, veçanërisht nga një pyetje idiote: a nuhasja ndonjë erë të keqe?! Në fillim s'ia mora për ters, por kur ma përsëriti, mendova se po

tallej. Qejfprishur u futa në vaskë. Ai mbushi gotat me shampanjë, e ne pimë më shumë se gjysmën e shishes, e do ta kishim pirë të gjithë sikur ai të mos kujtohej se nuk ndodheshim aty për të pirë. Kur u kujtua, më kërkoi t'i shkoja pranë. Ashtu bëra, i rrëshqita sipër, në trup. Ai më tërhoqi nga vetja dhe, në atë çast, mbi gjoksin e tij, ku kisha mbështetur duart, sytë më zunë një plagë, te sisa e majtë. Të thuash se dikush e kishte kafshuar.

Përgjithësisht unë nuk i drejtoj pyetje. Atij nuk i pëlqejnë pyetjet, sidomos lidhur me jetën private. Atë pasdite, plagën që i ngjante një të kafshuare, unë nuk e futa në kategorinë e hollësive të jetës së tij private. Përkundrazi, m'u duk e arsyeshme ta pyesja ç'ishte. Kjo përkoi me çastin kur ai u orvat të më depërtonte. Nuk e shpjgoj dot përse pas pyetjes sime ai pësoi një frenim. Seksi i tij u squll, u shfry, u shndërrua në krimb. Këtë metamorfozë unë e përjetova në një pozicion qesharak, sipër tij. Për herë të parë kuptova mirëfilli domethënien e shprehjes "as të qi, as të lëshon". Ai u përpoq më kot të ringjallej. Krimbi i tij i ngordhur nuk mund të ringjallej. Dhe më pushtoi një ndjenjë faji. Sikur përgjegjëse për metamorfozën e seksit të tij të isha unë. Këtë e lidha me pyetjen pa vend për plagën mbi sisën e majtë në çastin kur ai u orvat të më depërtonte. Po ç'lidhje mund të ketë midis pyetjes sime dhe ngordhjes së seksit të tij?"

Iluzioni se s'kishte ndodhur asgjë, se gjithçka kishte qenë një ëndërr e keqe, u shkërmoq në mëngjesin e ditës së pestë. Ai u zgjua si zakonisht në orën shtatë e tridhjetë minuta. Dhe, si zakonisht, para se të kthehej te “Pulëbardha”, vajti të merrte gazetatat te kioska në kryqëzimin e rrugëve. Në grumbullin e gazetave të ekspozuara përbri njëra-tjetrës mbi një tezgë jashtë kioskës, shitësi zgjodhi katër prej tyre. Ato që parapëlqente klienti i ri. Ai nuk lodhej shumë të mbante mend fytyrat e klientëve, aq më pak gazetatat që ata parapëlqenin. Por klienti i ri iu ngulit në kujtesë menjëherë. Ndoshta për shkak të pamjes së tij. Mbante veshur pantallona të lehta verore prej cohe të bardhë. Një floknajë të dendur, ndarë me vizë anash. Mustaqe të zeza. Më mbresëlënësja: fytyra e tij e hequr. Dhe një vështrim i ethshëm. Prej disa ditësh ai paraqitej në të njëjtën orë, merrte të njëjtat gazeta, pa harruar t'i linte bakshish. Klient i veçantë, s'mund të mos i binte në sy.

Tjetri nuk e vuri re zellin e shitësit për t'i shërbyer. Mori gazetatat, i futi nën sqetull, pa i hapur, dhe u kthye te “Pulëbardha”. Atje zuri vend në qoshen e tij. Dina nuk kishte mbërritur ende tek ai, kur në ballinën e gazetës “Epoka”, - ajo i rastisi e para, - lexoi: “Zhduket tetëmbë-dhjetëvjeçarja”. Portretin e vajzës e njohu menjëherë, megjithëse fotografia ishte e